



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.01.2021

**MBLEDHJA Nr. 04,
datë 25.01.2021, ora 13:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 25.01.2021, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 04 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

- 1- Mbi licencimin e shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “pishat” me kapacitet të instaluar 1911 kW;
- 2- Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 183, datë 13.11.2020, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e Shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike;
- 3- Mbi licencimin e Shoqërisë “ES 2019” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike;
- 4- Mbi kërkesën e OSSH sh.a. lidhur me përdorimin e vlerave zëvendësuese të konsumit të energjisë elektrike përgjatë periudhës së zbatimit të masave parandaluese ndaj COVID 19.
- 5- Mbi aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për miratimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike në nivel tensioni për vitin 2021

- 6- Mbi aplikimin e shoqërisë FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL sh.a për miratimin e çmimit së shërbimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2021.

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI